



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

Nr. 177 Prot.

Tiranë, më 19.04.2022
(Lutemi referojuni në rast përgjigje)

LËNDA: Njoftim për vend të lirë pune.

Në zbatim të Vendimit nr. 109, datë 15.02.2017 të Këshillit të Ministrave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë e të Bordit të Akreditimit dhe për përcaktimin e tarifave për proceset e sigurimit të cilësisë në Arsimin e Lartë” i ndryshuar, Urdhërin e Kryeministrit Nr.20, datë 26.01.2021 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë”, dhe në VKM Nr.143 datë 12.03.2014 “Për procedurat e rekrutimit, të përzgjedhjes, të periudhës së provës, të levizjes paralele e të ngritjes në detyrë për nëpunësit civil të kategorisë ekzekutive, të ulët e të mësme drejtuese”, Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL), shpall njoftimin për 1 (një) vend të lirë pune në pozicionin e **Specialist Finance në Sektorin e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse.**

Të interesuarit duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

I. Kërkesa të përgjithshme për kandidatin:

1. Të ketë përfunduar arsimin e lartë dhe të zotërojë një diplomë universitare të paktën Master Shkencor ose ekuivalent me të, në shkencat Ekonomi-Financë.
2. Të ketë përvojë pune të paktën 10 vjetare në fushën përkatëse, në institucione shtetërore ose private, si edhe të demonstrojë aftësi të theksuara operative.
3. Të ketë njohuri të mira të parimeve dhe praktikave financiare, buxhetore dhe planifikimin fiskal.
4. Të ketë përvojë pune në mbajtjen e kontabilitetit, llogarive dhe nxjerrjen e pasqyrave financiare në institucionet publike.
5. Të ketë përvojë pune në rakordimet me të dhënat nw degën e Thesarit dhe MAS për përdorimin e buxhetit në kryerjen e transaksioneve të ndryshme.
6. Të ketë njohuri të mira të praktikave të administratës publike.
7. Të ketë njohuri të kuadrit ligjor financiar në fuqi në Shqipëri.
8. Të ketë njohuri të programeve dhe aplikacioneve profesionale të fushës së financës dhe buxhetit, : Alfa buxhetor, Financë 5.
9. Të ketë aftësi të mira komunikuese dhe menaxhuese.
10. Të jetë i/e aftë të përpilojë, analizojë dhe përgatisë raporte dhe të dhëna financiare që lidhen me fushën e veprimtarisë.

Adresa: Rruga e Durrësit, Nr. 219, Tiranë; Tel: +355(0)2243423/2266203;
web: www.ascal.al; e-mail: info@ascal.al

11. Të ketë aftësi në vendosjen dhe ruajtjen e marrëdhënieve efektive të punës me insitucionet publike dhe më gjerë.

II. Kërkesa të veçanta për kandidatin:

1. Të ketë njohuri të përgjithshme për administratën publike dhe institucioneve të saj.
2. Të ketë njohuri për legjislacionin bazë të arsimit të lartë në përgjithësi dhe atij që lidhet me cilësinë.
3. Të ketë dhe dëshmojë aftësi të mira të drejtimit, bashkëveprimit dhe aftësi në shkrim dhe komunikim.

III. Dosja e aplikuesit duhet të përmbajë:

1. Jetëshkrimin (*Curriculum vitae*)
2. Kërkesën me shkrim dhe kontaktin personal
3. Diplomën dhe listën e notave të noterizuar
4. Dëshmi të kualifikimeve pasuniversitare të kryera apo në proces
5. Fotokopjen e librezës së punës; e noterizuar
6. Dëshmia e gjuhës angleze/huaj e noterizuar
7. Fotokopje të dëshmimeve të kualifikimeve të kryera, të noterizuara
8. Vlerësime pune nga punëdhënësi/t e mëparshëm.
9. Vërtetimin e Gjendjes Gjyqësore

Vlerësimi i kandidatëve do të bëhet me sistem pikëzimi, mbi bazën e dokumentacionit, njohjes së aftësive kompjuterike dhe gjuhës së huaj dhe përmes një interviste në prani të një komisioni të ngritur posaçërisht për këtë qëllim.

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë ASCAL dosjen me dokumentacionin e kërkuar deri më datën 25.04.2022, ora 12.00 në adresën e mëposhtme;

Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë.

Rruga e Durrësit, pranë Gjimnazit "Qemal Stafa"

Tel: 4 22 43 423

- Njoftimi të bëhet edhe në web site e Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë; www.ascal.al

DREJTORI

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR
PËRGJEGJËS SEKTORI PVC**

Xhiliola Bixheku

Adresa: Rruga e Durrësit, Nr. 219, Tiranë; Tel: +355(0)2243423/2266203;
web: www.ascal.al; e-mail: info@ascal.al